

Raporti i tryezës

“Dimensioni dixhital i dhunës ndaj grave: njohja dhe luftimi i fenomenit”

11 maj 2022
Prishtinë



Ky dokument është hartuar në kuadër të projektit të Këshillit të Evropës “Fuqizimi i luftës kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje në Kosovë - Faza III”.*

Pikëpamjet e shprehura këtu në asnjë mënyrë nuk duhet të merret për të pasqyruar mendimin zyrtar të secilës palë.

Mendimet e shprehura në këtë vepër janë përgjegjësia e autorëve dhe jo domosdoshmërisht pasqyrojnë politikën zyrtare të Këshillit të Evropës.

Të gjitha kërkesat në lidhje me riprodhimin ose përkthimin i të gjithë ose një pjese të këtij dokumenti duhet drejtuar Drejtorisë së Komunikimit (F-67075 Strasburg Cedex ose publishing@coe.int).

E gjithë korrespondenca tjetër në lidhje me këtë dokument duhet t’i drejtohet Divizionit të Barazisë tek Drejtoria e Përgjithshme e Demokracisë.

*Imazhi i kopertinës i përdorur
Me autorizimi i licencës Shutterstock Premier.*

©Këshilli i Evropës

*Kopertina dhe faqosja: Tomato Studio
Prishtinë, Kosovë **

**Të gjitha referencat për Kosovën, qoftë për territor, institucione, ose popullsi, në këtë tekst duhet të kuptohen në përputhje të plotë me Rezolutën 1244 të KS të OKB-së dhe pa paragjykuar statusin e Kosovës.*

Tryeza hibride “Dimensioni dixhital i dhunës ndaj grave: njohja dhe luftimi i fenomenit”

Ambasada e Italisë në Prishtinë (që përfaqëson Presidencën italiane të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës) dhe zyra e Këshillit të Evropës në Prishtinë shënuan 11 vjetorin e Konventës së Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (Konventa e Stambollit) duke organizuar një tryezë diskutimi mbi dimensionin dixhital të dhunës ndaj grave.

Tryeza kishte qëllim të trefishtë:

- Ndërgjegjësimi për njohjen dhe identifikimin e dukurisë alarmante të dimensionit dixhital të dhunës ndaj grave në format e ndryshme të saj.
- Fillimi i dialogut mes akterëve për të ndërmarrë veprime për të ofruar një përgjigje gjithpërfshirëse ndaj dhunës dixhitale ndaj grave.
- Të japë rekomandime konkrete dhe praktika më të mira për masat për të luftuar dimensionin dixhital të dhunës ndaj grave.

Tryeza hibride mbledhi fizikisht rreth **30 pjesëmarrës dhe rreth 20 nga distanca**, përfshirë përfaqësues të autoriteteve lokale, të shoqërisë civile, ekspertë të fushës, akademikë dhe përfaqësues nga organizatat ndërkombëtare.

Konventa e Stambollit është traktati ndërkombëtar më gjithpërfshirës për të trajtuar dhunën ndaj grave. Ajo definon format e ndryshme të dhunës duke përfshi dhunën fizike, seksuale, psikologjike dhe ekonomike, e cila ndër të tjera përfshin përndjekjen, ngacmimin seksual, gjymtimin e organeve gjenitale femërore, martesën e detyruar, abortin e detyruar dhe sterilizimin e detyruar.

Përparimi i teknologjisë ka mundësuar mjete të reja të manifestimit të formave të dhunës ndaj grave. Një [raport](#) i publikuar nga Laxton/ Women's Aid tregon se 45% e viktimave të dhunës në familje kanë raportuar se kishin përjetuar një formë abuzimi në internet gjatë marrëdhënies së tyre dhe 48% kanë raportuar se kishin përjetuar ngacmime ose abuzime në internet nga ish-partneri i tyre pas ndarjes.

Dhuna në dimensionin dixhital prek gratë dhe vajzat në mënyrë disproporcionale, gjë që shpesh kalon pa u vënë re dhe raportohet më pak. Grupi i Ekspertëve për Veprim kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (GREVIO) miratoi [rekomandimin e tij të parë të përgjithshëm mbi dimensionin dixhital të dhunës ndaj grave më 20 tetor 2021](#). GREVIO u bën thirrje shteteve palë të Konventës të njohin natyrën gjinore të dhunës dhe abuzimit të kryer përmes teknologjisë dhe poashtu kërkon një përgjigje gjithpërfshirëse.



RENDI I DITËS

10:00 Fjala e mirëseardhjes

- **Tankut Soykan**, Zëvendës Shef i Zyrës, Zyra e Këshillit të Evropës në Prishtinë
-

10:05 Folësit kryesorë

- **Shkëlqesia e Tij Antonello De Riu**, Ambasador, Ambasada e Italisë në Prishtinë
 - **Dr. Nita Shala**, Zëvendës Ministre e Drejtësisë/ Koordinatorë Nacionale kundër Dhunës në Familje
-

10:20 Prezantimet e panelit të ekspertëve

- **Maria-Andriani Kostopoulou**, nënkryetare e dytë e GREVIO
"Rekomandimi i Përgjithshëm Nr.1 i GREVIO-s në dimensionin dixhital të dhunës ndaj grave"
 - **Olivia Soave**, Menaxhere e Lartë për Marrëdhëniet me Jashtë në Kaspersky
"Zgjidhje teknologjike për të luftuar dhunën me bazë gjinore në internet"
-

11:00 Diskutim në panel: "Si të luftohet dimensionin dixhital i dhunës ndaj grave – rruga përpara"

Moderatore: **Kaltrina Ajeti**, Gazetare dhe kryeredaktore

Panelistët:

- **Nazlie Bala**, Këshilltare Politike e Ministres së Drejtësisë
 - **Sevdije Morina**, Zëvendës Kryeprokurore, Prokuroria e Shtetit
 - **Edi Gusia**, Drejtoreshë Ekzekutive, Agjencia për Barazi Gjinore
 - **Luljeta Demolli**, Drejtoreshë Ekzekutive, Qendra për Studime Gjinore
 - **Mentor Hoxhaj**, Kryetar i OJQ "Cybersecurity and Privacy (CSP)"
-

11:50 Diskutim i hapur

12:10 Fjala përmbyllëse

- **Tankut Soykan**, Zëvendës Shef i Zyrës, Zyra e Këshillit të Evropës në Prishtinë
-

10:00 | Fjala e mirëseardhjes

Tankut Soykan | Zëvendës Shef i Zyrës, Zyra e Këshillit të Evropës në Prishtinë

Z. Soykan përshëndeti pjesëmarrësit, shprehu mirënjohjen e tij për të gjithë ata që iu bashkuan tryezës dhe prezantoi qëllimin e ngjarjes që u organizua bashkërisht nga Ambasada e Italisë në Prishtinë nën Presidencën italiane të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës, dhe Zyra e Këshillit të Evropës në Prishtinë si pjesë e projektit "Fuqizimi i luftës kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje në Kosovë* - faza III".



"Përparimi i teknologjisë na ka mundësuar të lidhemi, të ndajmë informacione të rëndësishme, të flasim dhe të rrisim ndërgjegjësimin për shkeljet e të drejtave të njeriut. Por ajo ka ofruar gjithashtu baza të tjera për dhunën me bazë gjinore ndaj grave dhe vajzave në një masë alarmante dhe pak përgjegjësi. Kjo është arsyeja pse këtë vit Grupi i Ekspertëve për Veprim kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (GREVIO) miratoi rekomandimin e parë të përgjithshëm mbi dhunën ndaj grave në internet".

Z. Soykan prezantoi panelin e ekspertëve dhe panelin e diskutimit të kësaj tryeze dhe objektivat e saj.

10:05 | Folësit kryesorë

Shkëlqesia e Tij Antonello De Riu, Ambasador, Ambasada e Italisë në Prishtinë



Ambasadori De Riu falenderoi të gjithë për pjesëmarrjen e tyre në tryezë dhe vuri në dukje shkallën në zhvillim të shpejtë të të gjitha formave të dhunës ndaj grave, përfshirë dimensionin dixhital të saj që kërkon vëmendjen dhe reagimin tonë të shpejtë.


Ambasadori De Riu theksoi "Një në dy gra në BE ka përjetuar dhunë fizike ose seksuale që nga moshë 15 vjeçare, një në dy ka përjetuar ngacmim seksual, një në njëzet e pesë është përdhunuar dhe një në pesë gra ka përjetuar përndjekje".

Ambasadori De Riu theksoi se aspekti shumëdimensional i këtij fenomeni mund të zgjidhet në mënyrë efikase vetëm nëpërmjet partneritetit dhe bashkëpunimit ndër-institucional me akterët qeveritarë dhe joqeveritar që veprojnë në të gjitha nivelet territoriale.

Dr. Nita Shala | Zëvendës Ministre e Drejtësisë/ Koordinatore Nacionale kundër Dhunës në Familje

Dr. Shala shprehu vlerësimin e lartë për ngjarjen dhe konkretisht temën, duke pasur parasysh praninë e shtuar të dhunës ndaj grave në dimensionin dixhital, veçanërisht gjatë pandemisë Covid-19. Dr. Shala theksoi përkushtimin për të rritur ndërgjegjësimin për këtë dimension të dhunës, për të rritur informacionin e kufizuar që kemi për të dhe për të ndërmarrë iniciativë më të koordinuar për të identifikuar shqetësimet para shfaqjes së dëmit dhe për të siguruar që legjislacioni vendor para shfaqjes së dëmit dhe për të siguruar që legjislacioni vendor në fuqi është duke u zbatuar. Dr. Shala theksoi se bashkëpunimi i institucioneve me akterët e tjerë mbetet i një rëndësie të madhe.

"Strategjia Kombëtare për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj Grave 2022-2026 e miratuar në janar të këtij viti, ka përfshirë disa aktivitete që përfshijnë mediat në parandalimin dhe identifikimin e dhunës. Vetëm duke punuar së bashku mund t'i japim fund dhunës ndaj grave në të gjitha sferat."



10:20 | Prezantimet e panelit të ekspertëve

Maria-Andriani Kostopoulou | nënkryetare e dytë e GREVIO

“Rekomandimi i Përgjithshëm Nr.1 i GREVIO-s për dimensionin dixhital të dhunës ndaj grave”

GREVIO është organi i pavarur i ekspertëve përgjegjës për monitorimin e zbatimit të Konventës së Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (Konventa e Stambollit).

Në nëntor 2021, GREVIO publikoi Rekomandimin e Përgjithshëm për dimensionin dixhital të dhunës ndaj grave, duke ofruar një grup të ri dhe specifik rekomandimesh. Rekomandimi i ka rrënjët në Konventën e Stambollit dhe propozon veprime specifike që duhen ndërmarrë bazuar në katër shtyllat e Konventës së Stambollit - Parandalimi, Mbrojtja, Ndjekja penale dhe Politikat e Koordinuara. Përveç kësaj, shumë forma të dhunës ndaj grave të kryera përmes mjeteve dixhitale kërkojnë të kriminalizohen, duke përfshirë edhe përndjekjen.

Znj. Kostopoulou theksoi se dhuna psikologjike (e mbuluar në nenin 33 të Konventës së Stambollit), është shumë e lidhur me të gjitha format e dhunës psikologjike dixhitale dhe online. Një raport i publikuar nga Women's Aid tregon se 45% e viktimave të dhunës në familje raportuan se kishin përjetuar një formë abuzimi në internet gjatë marrëdhënies së tyre dhe 48% raportuan se kishin përjetuar ngacmim ose abuzim në internet nga ish-partneri i tyre pasi kishin lënë lidhjen. Rreth 38% raportuan përndjekje në internet pasi kishin lënë marrëdhënien, dhe 75% raportuan se policia nuk dinte si t'i përgjigjej abuzimit dhe ngacmimit në internet.

Përndjekja (e mbuluar në nenin 34 të Konventës së Stambollit) në dimensionin dixhital bëhet duke spiunuar, vjedhur fjalëkalimet e viktimave ose hakerimin e llogarive të tyre. Forma moderne e ndjekjes është instalimi i programeve të spiunitmit (spyware) ose përdorimi i pajisjeve të lidhura për të përndjekur viktimën.

Disa nga veprimet e propozuara të Rekomandimit të Përgjithshëm Nr.1 të GREVIO mbi dimensionin dixhital të dhunës ndaj grave përfshijnë:

Parandalimi: *Edukimi dhe trajnimi i profesionistëve, duke sfiduar stereotipet dhe praktikat e dëmshme; rritja e njohurisë dixhitale, veçanërisht tek gratë dhe vajzat; ngritja e kapaciteteve të ofruesve të kujdesit shëndetësor dhe gjyqtarëve dhe prokurorëve për manifestimin e dhunës online; të ndërmerren veprime për të zhvilluar fushata ndërgjegjëse; motivimin e organizatave mediatike dhe gazetarëve në ndalimin e qasjes të fajësimit të viktimave.*

Mbrojtja: *Qasja e shërbimeve në të gjithë vendin; zhvillimi dhe shpërndarja e informacionit mbi mekanizmat ligjorë për dhunën dixhitale; pajisja e shërbimeve mbështetëse të grave me burime financiare dhe njerëzore, duke përfshirë këshillimin psikologjik dhe këshillimin ligjor; krijimi i mekanizmave që do të sigurojnë moderim të shpejt të përmbajtjes që bie ndesh me parimet e Konventës së Stambollit. Për shembull, ata mund të heqin përmbajtjen ose llogarinë.*

Ndjekja penale: *Bashkëpunimi ndërkombëtar dhe kapacitetet e ndihmës juridike të ndërsjellë të aktorëve të drejtësisë penale në çështjet që lidhen me dimensionin dixhital të dhunës ndaj grave duhet gjithashtu të ngriten me synimin për të siguruar qasje të lehtë në provat e mbajtura nga ofruesit e shërbimeve, duke përfshirë informacionin e nënshkruesit (subscriber) për të identifikuar pronarin e një llogarie ose e një adrese IP të përdorur në kryerjen e një shkelje; Inkurajoni sektorin privat dhe TIK që të marrë pjesë në hartimin dhe zbatimin e politikave dhe vendosjen e udhëzimeve dhe standardeve vetërregulluese në përputhje me dispozitat përkatëse të të drejtave të njeriut për të parandaluar dhe luftuar dhunën ndaj grave që ndodh në sferën dixhitale.*

Politikat e bashkërenditura: hartoni dhe zbatoni politika gjithëpërfshirëse dhe të koordinuara në të gjitha nivelet e qeverisjes dhe nga të gjitha agjencitë dhe institucionet përkatëse, duke përfshirë agjencitë qeveritare, OJQ-të, parlamentet dhe autoritetet kombëtare, rajonale dhe lokale; alokimi i burimeve të duhura njerëzore dhe financiare për organet e qeverisjes kombëtare dhe vendore, si dhe për ndihmën juridike, institucionet e kujdesit shëndetësor dhe mbrojtjes sociale, duke përfshirë organizatat e grave, për të parandaluar, mbrojtur dhe ndjekur në mënyrë efektive dhunën ndaj grave të ushtruar në internet dhe nëpërmjet teknologjisë.

Rekomandimi i plotë i GREVIO mbi dimensionin dixhital të dhunës ndaj grave gjendet [këtu](#)

Olivia Soave | Menaxhere e Lartë për Marrëdhëniet me Jashtë në Kaspersky "Zgjidhje teknologjike për të luftuar dhunën me bazë gjinore në internet"

Znj. Soave prezantoi zgjidhje teknologjike, duke dhënë shembuj nga këndvështrimi i kompanisë së sigurisë Kaspersky. Kaspersky punon ngushtë me sektorin publik dhe privat dhe angazhon shumë akter në aktivitetet e tij. Kompania merret me abuzimin e facilituar nga teknologjia dhe veçanërisht "Stalkerware", që i mundëson një autori të spiunojë fshehurazi jetën private të një personi tjetër. Ajo theksoi se kompanitë e teknologjisë mund dhe duhet të jenë pjesë e zgjidhjes në luftën kundër dimensionit dixhital të dhunës ndaj grave.

Stalkerware është një softuer i njohur që përdoret për spiunim dhe përndjekje kibernetike. Edhe pse i paligjshëm në shumicën e vendeve, është i lehtë për t'u blerë, instaluar dhe përdorur. Koalicioni Kundër Stalkerware vlerëson se përdorimi i tij tejkalon 1 milion incidenca në vit.

Koalicioni Kundër Stalkerware synon të adresojë dhe t'i përgjigjet Stalkerware duke kombinuar ekspertizën e partnerëve të tij në mbështetjen e të mbijetuarve të dhunës në familje dhe punën e dhunuesve, mbrojtjen e të drejtave dixhitale dhe sigurinë kibernetike për të trajtuar sjelljen kriminale të kryer nëpërmjet stalkerware. Koalicioni e trajton këtë çështje me më shumë se 40+ anëtarë nga e gjithë bota, duke krijuar bashkëpunim ku aktorë të ndryshëm duke përfshirë kompanitë e sigurisë së IT, kërkimin akademik, agjencitë e zbatimit të ligjit, Interpolin dhe duke rritur ndërgjegjësimin për këtë çështje.

Koalicioni Kundër Stalkware punon në tre drejtime:

- 1. Rritja e ndërgjegjësimit dhe trajnimi:** duke ndarë njohuritë, duke mbledhur të dhëna dhe duke diskutuar terminologjinë me OJQ-të dhe lojtarët e tjerë. Vitin e kaluar, Kaspersky ofroi një trajnim teknik për më shumë se 20 zyrtarë të zbatimit të ligjit, në bashkëpunim me Interpolin. Kaspersky dhe anëtarë të tjerë të Koalicionit janë gjithashtu pjesë e projektit DeStalk, një projekt kërkimor i financuar nga fondet evropiane. Në kuadër të projektit, u zhvillua një trajnim mbi stalkerware dhe dhunën kibernetike për subjektet publike dhe organizatat që mbështesin viktimat e dhunës në familje.
- 2. Zgjidhje të bazuara në teknologji për të luftuar Stalkerware:** një shembull është mjeti i zbulimit të Stalkerware i quajtur Tiny Check i cili është falas. Qëllimi i Tiny Check është të ndihmojë organizatat jofitimprurëse të mbështesin viktimat e dhunës ndaj grave ose dhunës në familje dhe të mbrojnë privatësinë e tyre. Mjeti nuk e informon autorin për skanimin, kontrollon të gjitha pajisjet e mundshme, është i përballueshëm dhe si burim i hapur. Ai po përdoret gjithashtu nga organet e zbatimit të ligjit, organet gjyqësore si dhe nga shumë të tjerë në mbarë botën.
- 3. Sigurimi i sinjalizimeve për privatësinë:** Ofrimi i paralajmërimeve më të detajuara për përdoruesit përmes zgjidhjeve antivirus.

11:00 | Diskutim në panel: “Si të luftohet dimensionin dixhital i dhunës ndaj grave – rruga përpara”

Nazlie Bala | Këshilltare Politike e Ministrit të Drejtësisë

Znj. Bala theksoi se të gjitha format e dhunës janë të sanksionuara me ligj dhe të kriminalizuara nga Kodi Penal, edhe kur ajo ndodh në dimensionin dixhital. Baza e të dhënave për dhunën në familje në Ministrinë e Drejtësisë nuk ka kategori specifike për dhunën në dimensionin dixhital, prandaj nuk ka të dhëna për rastet dhe as numrin e dënimeve.

Strategjia Kombëtare për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj Grave 2022-2026, e cila bazohet në Konventën e Stambollit, trajton çështjen e dhunës dixhitale në planin e saj të veprimit.

Sevdije Morina | Zëvendës Kryeprokurore, Prokuroria e Shtetit

Znj. Morina shprehu shqetësimin për këtë fenomen kompleks dhe faktin se ai prek në mënyrë disproporcionale gratë dhe vajzat. Ajo përmendi se edhe koleget e saj gra janë pjesë e sulmeve me komente ofenduese në rrjetet sociale, gjë që i bën ato të hezitojnë të marrin pjesë në media.

Fjala dixhitale përdoret rrallë në Kodin Penal, por ngacmimi nëpërmjet internetit, dhuna nëpërmjet internetit, frikësimi që bëhet me fjalë veprimet dhe gjetet, shantazhi dhe forma të tjera të ngacmimeve telefonike me telefonata të shpeshta, mesazhe dhe letra dhe ngacmime janë të njohura si vepra penale. Kur raportohen raste të tilla dhe nis hetimi, hapi i parë është marrja e pajisjeve elektronike të autorit. Si sfida ajo përmendi se një rast nuk mund të ndiqet penalisht nëse nuk përputhet saktësisht me përshkrimin e veprës penale.

Znj. Morina shprehu shqetësimin edhe për mungesën e psikologëve të specializuar për dhunën në familje në raste të tilla, të cilat janë të një rëndësie të madhe gjatë marrjes në pyetje.

Edi Gusia | Drejtoreshë Ekzekutive e Agjencisë për Barazi Gjinore

Mungesa e grave në jetën politike dhe publike, stereotipet me bazë gjinore dhe mentaliteti patriarkal kanë ndikuar që dhuna të prekë në mënyrë disproporcionale gratë dhe vajzat. Edukimi i të rinjve për parandalimin e dhunës duhet të adresohet duke filluar nga shkolla fillore, ndërsa fokusi primar është parandalimi i dhunës dhe jo korrigjimi i tij.

Agjencia për Barazi Gjinore (ABGJ) ka bërë një hulumtim mbi rolin e mediave në ndikimin e stereotipeve në nxitjen e seksizmit dhe rezultatet tregojnë shumë situata ku gratë janë viktima të sulmeve mediatike. ABGJ ka mbajtur gjithashtu trajnime specifike për konceptet bazë për parandalimin e qasjeve seksiste dhe informacionin e bazuar në parimet e barazisë gjinore me zyrtarët qendror dhe lokal të informimit; kompanitë mediatike; dhe studentë e gazetarisë.

Media mund të përdoret për të informuar të rinjtë për kornizën ligjore e cila siguron barazinë gjinore. Znj. Gusia përmendi se mungojnë treguesit e UNESCO-s që do të informonin mediat për eliminimin e gjuhës seksiste ndaj grave.

ABGJ ka hartuar gjithashtu një manual për edukimin e brezave të rinj në frymën e barazisë gjinore dhe ka bërë hulumtime për të përmirësuar kurrikulat arsimore që përmbajnë gjuhë seksiste.

“Institucionet vendore po funksionojnë ngadalë në rastet e raportimeve të dhunës dixhitale ndaj grave, duke shkaktuar kështu frikë dhe pasiguri tek gratë për raportimin e dhunës.”

Luljeta Demolli | Drejtoreshë Ekzekutive e Qendrës për Studime Gjinore

OJQ “Qendra për Studime Gjinore” kreu një hulumtim në vitin 2012 duke pyetur të rinjtë se sa e kontrollojnë njëri-tjetrin në internet dhe gjetjet janë alarmante. Përdorimi i teknologjisë është shumë i përhapur, sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës mbi 93% e familjeve përdorin rregullisht internetin.

Znj. Demolli theksoi se gratë e moshës së mesme që përdorin rrjetet sociale janë veçanërisht të cenueshme. Ato janë më pak të informuara për përdorimin e sigurt të internetit dhe shumë shpesh mund të jenë viktimat e dhunës në internet. Një tjetër shqetësim i madh është dhuna dhe ngacmimi i grave në politikë. Këto gra po sulmohen nga bullizmi kibernetik dhe kjo çështje nuk po trajtohet sa duhet.

Bashkëpunimi institucional është thelbësor në parandalimin e këtij fenomeni dhe autoritetet vendore duhet të rrisin bashkëpunimin me shoqërinë civile. OJQ-të e grave shpesh konsiderohen më të besueshme nga viktimat dhe shumë shpesh ato raportojnë dhunën direkt tek OJQ-të përpara se të shkojnë në polici. Për më tepër, OJQ-të kryejnë hulumtime dhe kanë të dhëna të konsiderueshme të fushës, të cilat mund të përdoren nga autoritetet vendore.

Kërcënimet në internet duhet të merren më seriozisht dhe si rrjedhojë duhet të ketë reagim të shpejtë nga autoritetet lokale. Nëse dikush kërcënon në internet se do t’ju marrë jetën, rreziku është i lartë që ky person ta bëjë këtë në jetën reale. Duhet të kemi parasysh qarkullimin e shpejtë që bëhet përmes internetit dhe dhuna e shkaktuar në formë dixhitale mund të përhapet shumë shpejt, ndaj reagimi duhet të jetë shumë më i shpejtë.

Mentor Hoxhaj | Udhëheqës i OJQ-së “Cybersecurity and Privacy (CSP)”

Z. Hoxhaj theksoi sfidat politike në përdorimin e platformave online dhe rrjeteve sociale dhe ndikimin negativ që ato sjellin në parandalimin dhe luftimin e dhunës përmes platformave digjitale. Për faktin se Kosova* nuk njihet nga platformat dixhitale, as nga Google dhe as nga Microsoft, nuk është i mundur raportimi i dhunës online që ofrojnë këto platforma.

Në duhet të shmangim platformat dixhitale ku fotot dhe videot shpërndahen me shpejtësi jashtëzakonisht të madhe. Rrjetet sociale nuk janë të sigurta, madje as ato si Snapchat që promovojnë që fotot dhe videot shkatërrohen në çast, kjo nuk është e vërtetë. Platforma TikTok është shumë e vështirë për t’u kontrolluar dhe përdoret në masë të madhe nga adoleshentët edhe nga fëmijët. Policisë së Kosovës i është ofruar një softuer i cili identifikon imazhet nudo dhe ndalon përhapjen e fotografive të identifikuara në internet, mirëpo nuk ka asnjë informacion mbi përdorimin e këtij softueri.

“Pjesa më e rëndësishme në parandalim është edukimi dhe ka nevojë për bashkëpunim të vazhdueshëm institucional në nivel kombëtar dhe lokal”.



Rekomandimet dhe hapat e ardhshëm për autoritetet vendore të identifikuara gjatë panelit dhe diskutimit të hapur:

E PËRGJITHSHME:

- Të rritet bashkëpunimi ndër-agjenci dhe ndër-institucional në luftën kundër dhunës dixhitale ndaj grave.
- Të përfshihet komponenta dixhitale e dhunës ndaj grave në të gjitha legjislationet dhe mekanizmat përkatëse dhe të krijohet një forum kombëtar që do të trajtonte dhunën në internet.
- Të ofrohet edukimi i gjerë në nivel lokal duke targetuar gjeneratat e reja mbi përdorimin e sigurt të teknologjisë dhe internetit.
- Të përfshihen psikologët të trajnuar të specializuar për dhunën ndaj grave dhe dhunën në familje në gjykata dhe prokurori gjatë marrjes në pyetje.

SPECIFIKE:

- Të zhvillohet një protokoll për rastet e dhunës në dimensionin dixhital për të mbledhur në mënyrë efektive provat dixhitale.
- Të ndërmerren fushata ndërgjegjëse mbi dhunën dixhitale ndaj grave, duke synuar bartësit e detyrave si nga shërbimet arsimore, shëndetësore dhe ato sociale.
- Të përfshihet e dhuna online në mbështetjen e linjës telefonike falas, kjo do ta bënte më të shpejtë reagimin ndaj fenomenit sesa të shkohet fillimisht në polici dhe të ndërmerret një procedurë e gjatë.
- Të përfshihet dhuna online në politikën ekzistuese të "tolerancës zero ndaj ngacmimit" brenda autoriteteve vendore. Çdo institucion duhet të ketë një adresë emaili ku ankesat mund të drejtohen në mënyrë anonime ose jo anonime.
- Të ndjeken penalisht personalitetet fetare me ndikim që nxisin urrejtje ose dhunë ndaj grave përmes platformave dixhitale (kryesisht përmes kanalit Youtube).

12:10 | Fjala përmbyllëse

Tankut Soykan | Zëvendës Shefi i Zyrës, Zyra e Këshillit të Evropës në Prishtinë

Diskutimi dinamik që u zhvillua gjatë kësaj tryeze hibride tregon se ky është një fenomen mjaft i pranishëm dhe kërkon një përgjigje gjithëpërfshirëse. Mësuam shumë gjatë këtij diskutimi dhe identifikuam hapa konkretë për adresimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave në dimensionin dixhital.

Z. Soykan shprehu mirënjohjen e tij për të gjithë pjesëmarrësit që ishin të pranishëm dhe kontribuan në diskutim.

Projekti i Këshillit të Evropës “Fuqizimi i luftës kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje në Kosovë* - Faza III” synon të përcaktojë një udhërrëfyes konkret për fuqizimin e kornizës ligjore dhe të politikave të Kosovës* si dhe ngritjen e kapaciteteve institucionale për të parandaluar dhe luftuar dhunën ndaj grave dhe dhunës në familje në përputhje me standardet e Konventës së Stambollit.

www.coe.int

Këshilli i Evropës është organizata udhëheqëse e kontinentit për të drejtat e njeriut. Përbëhet nga 46 shtete anëtare, duke i përfshirë të gjithë anëtarët e Bashkimit Evropian. Të gjitha shtetet anëtare të Këshillit të Evropës kanë nënshkruar Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, një traktat i projektuar për të mbrojtur të drejtat e njeriut, demokracinë dhe sundimin e ligjit. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut mbikëqyr zbatimin e Konventës në shtetet anëtare.